



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:242088  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05731891  
Ac.nr.638/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen çështjen juridike kontestimore të paditësit B.G., nga fsh. Komuna e S....., tani me vendbanim në L....., përfaqësuar nga av. Xhevat Balaj, nga Prishtina, Lagja “Ulpiana”, A5, H4, nr.5, kundër të paditurës Kolegji SHLP, QEAP “Heimerer”, me seli në Prishtinë, Veternik, afër Gorenjes, rruga për në fshatin Ndërkombëtar, përfaqësuar nga av. Kushtrim Palushi, nga Prishtina, rr. “Qamil Hoxha”, nr. 13/5, lidhur me çështjen juridike kompensim i pagave të pa paguara, në shumë prej 7,200.00€, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3239/16, i datës 03.09.2020, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 23.05.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e themeltë ankesa e autorizuarës së paditurës: Kolegji SHLP, QEAP “Heimerer”, me seli në Prishtinë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3239/16, i datës 03.09.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.3239/16, i datës 03.09.2020, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit B.G., nga fsh. Komuna e S.....

II. DETYROHET e paditura Kolegji SHLP, QEAP “Heimerer”, me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë, që paditësit B.G., nga fshati Fsh. Komuna e S....., ti kompensoj pagat e papaguara me kamatë si dhe beneficione tjera për periudhën 01.10.2016- 30.09.2017, në shumë të përgjithshme prej 7,200.00€ bruto, në emër ta pagave ta papaguara – pagat neto në shumën prej 6,178.20€ me kamatë ligjore prej 8%, po ashtu DETYROHET e paditura që në llogarinë e

paditësit pranë trustit pensional të Kosovës në emër të kontributit pensional në emër të paditësit si punëmarrës të paguaj shumën prej 360.00€, e po ashtu edhe në emër të paditurës si punëdhënës të paguaj shumën prej 360.00€, si dhe në emër të tatimit në pagë në llogari të buxhetit të Kosovës të paguaj shumën prej 661.80€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

III. DEYROHET e paditura Kolegji SHLP, QEAP "Heimerer", me seli në Prishtinë që paditëses që paditësit B.G., nga fshati Fsh. Komuna e S..... ti kompensoj shpenzimet e procedurës Kontestimore në shumë të përgjithshme prej 719.00€ (shtatëqindentëmbëdhjetë euro).

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar duke e prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke e refuzuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ose duke e aprovuar si të bazuar këtë ankesë dhe duke e prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit ka propozuar që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e palës së paditur si të pabazuar dhe të vërtetoj në tërësi si të bazuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarës të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datën 22.12.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kompensimin e të ardhurave personale, të precizuar si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 03.09.2020 me të cilën ka deklaruar se në bazë të ekspertizës financiare e bëjnë edhe precizimin e kërkesëpadiës e cila tani precizohet që e paditura detyrohet përveç që paditësen në emër të demit material - pagave të pa paguara ti kompenzoj shumën prej 6,178.20€ neto, për periudhën kohore 01.10.2016-30.09.2017, në emër të tatimit në pagë 668.80€, në emër të trustit pensional për të punësuarin-paditësin shumën prej 360.00€, si dhe e emër të trustit pensional për punëdhënësin - të paditurin shumën prej 360.00€, ti gjitha këto me kamatë prej 8, duke filluar qe nga data 01.10.2017, derisa aktgjykimi të merr formën e prere si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjithave shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3239/16, i datës 03.09.2020, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Nuk është kontestues në mes te ndërgjyqësve se te njëjtit me datë 10.11.2015, kanë nënshkruar Kontratë Pune, me te cilën paditësi themelon marrëdhënie punë pranë te paditurës në afat e pacaktuar. Po ashtu nuk është kontestuese se paditësi ka qenë aktiv dhe ka punuar pranë te paditurës deri me datën 30.09.2016, pa asnjë vërejtje nga ana e te paditurës për punën e bërë pranë saj. Kontestuese në mes te ndërgjyqësve është nëse i padituri ka punuar pranë te paditurës pas datës 30.09.2016, dhe nëse te njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës pas datës 14.11.2016.

Bazua në konstatimet si me lartë, gjykata vlerësoi kërkesëpadinë e paditësit dhe erdh në përfundim se e njëjta është e bazuar dhe atë për faktet si në vijim; nuk është kontestuese as në mes ndërgjyqësve se paditësi kishte të themeluar marrëdhënie pune pranë të paditurës në afat të pacaktuar që nga data 10.11.2015, faktin se viti shkollor- akademik fillon në Tetor, e ku edhe paditësi ishte aktive me aktivitet e tij pranë të paditurës në kuadër të detyrave të tij, si fakti esencial se e njëjta nuk ka provuar me asnjë provë faktet e saja të pretenduar se ka ekzistuar marrëveshja për ndërprerje të marrëdhënies së punës, e as fakti i njoftimit të paditësit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, i bërë para datës 11.11.2016. E paditura nuk ka prezantuar asnjë provë se ka ndërmarr asnjë veprim për ti ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit mbi ndonjë bazë tjetër ligjore, nuk ka prezantuar asnjë fakt, provë me të cilën vërtetohet se paditësi ka bërë shkelje të detyrave të punës, qka do të vinte deri të përfundimi se e njëjta ka vepruar drejt apo jo me rastin e shkeljes së marrëdhënies së punës. Andaj gjykata vlerësoi si të drejt pretendimin e paditësit se të njëjtit i është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme marrëdhënia e tij e punës sipas njoftimit me e-mail të datës 11.11.2016. Gjykata gjatë vlerësimit të pretendimeve të të paditurës, u ndal veçanërisht në vlerësimin e-mailave të datës 08.11.2016 dhe 11.11.2016, nga e-mail i datës 08.11.2016 veç faktit që janë pajtuar për pagese të muajit Tetor dhe Nëntor deri me datë 14 2016, nuk konfirmohet ndonjë marrëveshje, ndërsa nga e-mail i datës 11.11.2016, kemi një deklaram të palës se paditur se ka pasur marrëveshje për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe njoftim lidhur me këtë ndërprerje por që asnjëra nuk u provuan.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se në rastin konkret, gjykata pas vlerësimit të gjithë provave të bashkangjitura dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike si me lartë, duke aplikuar dispozitat ligjore të lartcekura, erdhi në përfundim se e paditura me rastin e shkeljes së marrëdhënies së punës nuk ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi (Ligjin e Punës), e njëjta lidhur me pretendimin e saj se marrëdhënien e punës paditësit i ka ndërprerë mbi bazën e marrëveshjes nuk arriti të argumentoj, e po ashtu e njëjta nuk prezantoi asnjë fakt, nga i cili do të vërtetohej se e paditura ka ndjekur rrugën ligjore për ti ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit, në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë e cila do të dëshmonte faktin e respektimit të dispozitave ligjore, andaj në këtë rast gjykata vlerëson se largimi i paditësit nga puna pa respektuar dispozitat ligjore, klasifikohet si largim i paligjshëm nga puna. Meqenëse u vërtetua me lartë se largimi i paditësit nga puna ishte i paligjshëm, gjykata duke zbatuar dispozitën e 80 paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit të Punës, vendosi që paditësi t'ia njoh kompensimin e pagave sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë duke u bazuar në ekspertizën financiare të datës 10.01.2020 nga e cila rezulton se paditësja si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nga data 01.12.2016 e deri më datë 31.12.2019, do të përfitonte pagën bruto në shumë prej 7,200.00 €, të cilat pas zbritjes së kontributit pensional në emër të punëdhënësit në shkallë prej 5% në shumë prej 360.00 €, si dhe tatimit në burim në shumë prej 661.80€, do të takonte paga neto në shumë prej 6,178.20 €. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të të paditurës të paraqitura gjatë këtij shqyrtimit, mirëpo të njëjtat ishin të pa ndikim në vendosjen ndryshe përpos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar neneve 10, 70, 71 dhe 80 të Ligjit të Punës.. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 450 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e atakuar dhe duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika k), n) të LPK-së, 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të

plotë dhe të drejtë, e për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika k) e LPK-së, qëndron për faktin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se përfaqësuesi i autorizuar e të paditurës, kanë qenë gjatë procedurës në gjykatën e shkallës së parë, duke u paraqitur në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuarit të paditurës, ku i njëjtit e ka përfaqësuar të paditurën edhe në seancat e shqyrtimit kryesor, mirëpo në shkresat e lëndës mungon autorizimi i përfaqësuesit të autorizuarit të paditurës, me çka në një situatë të tillë del se përfaqësuesit e autorizuar Kushtrim Palushi, nuk kanë pasur autorizim, që të përfaqësojnë të paditurën gjatë procedurës kontestimore të zhvilluar tek gjykata e shkallës së parë e as sipas mjeteve të goditjes-ankesës.

Po ashtu në shkresa të lëndës, përkundër faktit se nga gjykata e shkallës së parë në procesverbalin e seancave të shqyrtimit kryesor figuron konstatimi se për të paditurën prezentë përfaqësuesi i autorizuar Kushtrim Palushi, mungon autorizimi i të paditurës dhënë të njëjtit për ta përfaqësuar në këtë lëndë kontestimore.

Me nenin 93 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ I autorizuarit për përfaqësim ka për detyrë që me rastin e kryerjes se veprimit të parë në procedurë të paraqesë prokurën ”. Ndërsa me nenin 93 paragraf 4 të te njëjtit ligj, përcaktohet se: “ Gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim. Po qe se gjykata konstaton se personi që prezantohet si përfaqësues nuk është i autorizuar nga pala për një gjë të tillë, do ti anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi i tillë, po qe se veprimet e tij nuk i ka pranuar më vonë ”.

Po ashtu në këtë rast gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke e detyruar të paditurën që të njëjtës t’ia kompensoj të ardhurat personale mujore, mirëpo në shkresat e lëndës ekziston njoftimi përmes e-mailit i datës 11.11.2016 me të cilin paditëses i është i është ndërprerë kontrata e punës, mirëpo nëse i referohemi shkresave të lëndës shihet se nuk ekzistojnë prova të cilat vërtetojnë se njoftimi i lartcekur është anuluar apo ndryshuar në mënyrë që të krijohet baza për kompensimin e të ardhurave personale (posaçërisht për përudhen 11.11.2016 deri me 30.09.2017). Në këtë rast gjykata në procedurë kontestimore kur vendos sipas padisë së paraqitur nga punëtorja e vlerëson ligjshmërinë e vendimit kundër të cilit është ngritur padia dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara si dhe lloji i kërkesës së

paditëses merr vendim përkatës varësisht nga kërkesa e paditësit se për çka kërkon mbrojtje gjyqësore dhe gjykata në procedurë kontestimore duhet të kufizohet në shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve apo njoftimeve të kontestuara dhe ligjshmërinë e procedurave që i kanë paraprirë nxjerrjes së vendimeve, me të cilat pretendohet se punëtorit ju kanë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit apo njoftimit për anulimin e kontratës së punës, në të njëjtën procedurë mund të vendos edhe për kërkesat aksesore siç janë në këtë rast kompensimi i të ardhurave personale, gjë të cilën gjykata e shkallës së parë në këtë rast nuk e ka bërë.

Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, tani për tani vlerësohet se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara në atë mënyrë, fillimisht të urdhëroj përfaqësuesit e të paditurës Kushtrim Palushi, që brenda afatit të caktuar të paraqesin prokurën (autorizimin) e dhënë nga ana e të paditurës ose aprovimin e tyre për veprimet procedurale të kryera, të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës (vlerësimi i prezumimëve procedurale në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë dhe në seancën përgatitore), në atë mënyrë që fillimisht të konstatoj se në këtë rast a është kontestuese baza juridike sa i përket kompensimit të ardhurave personale të papaguara, nëse edhe me tej mbetet kontestuese baza juridike sa i përket kompensimit të ardhurave personale, të vlerësoj se a është anuluar njoftimi i të paditurës i datës 11.11.2016 me të cilin paditësit i është ndërprerë kontrata e punës, pastaj të vërtetoj faktin se paditësi a ka punuar për përudhen deri te ndërprerja e kontratës së punës, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. Me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitoje shkeljet procedurale të konstatuara si me lart nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.638/2021, me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit  
Naim Mehulli, d.v